



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, të enjten, më 7 shtator, Trupi Gjykues lëshoi vendimin e shtatë mbi pjesëmarrjen e viktimave, me të cilin pranoi një viktimë të re për pjesëmarrje në proces. Viktima do t'i shtohet grupit ekzistues të viktimave pjesëmarrëse dhe do të përfaqësohet nga i njëjti Mbrojtës i Viktimave.

Në vendim, Trupi Gjykues vuri në dukje se afati për paraqitjen e kërkesave për pranimin e viktimave për pjesëmarrje në këtë çështje gjyqësore ishte 15 shkurti 2023. Megjithatë, Gjykatësit konstatuan se kishte arsye të vlefshme për shqyrtim të informacionit shtesë dhe rivlerësim të kërkesës së ridorëzuar nga parashtruesi i kërkesës që ishte refuzuar më parë.

Bashkë me të, numri i gjithsejtë i viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore arrin në 141.

Në të njëjtën çështje, deri tani kanë dhënë dëshmi katër dëshmitarë në seancat e kësaj jave. Dëshmitari i 22-të i thirrur nga Prokuroria, Frederik Abrahams nga OJQ-ja ndërkombëtare *Human Rights Watch*, përfundoi dhënien e dëshmisë të hënën.

Pas përfundimit të dëshmisë së z. Abrahams, Prokuroria thirri të hënën dëshmitarin e radhës. Dëshmitari i 23-të i thirrur nga Prokuroria ishte dëshmitar i mbrojtur i cili dha dëshmi përmes videokonferencës dhe kryesisht në seancë private.

Dëshmia e një dëshmitari tjetër të mbrojtur, dëshmitarit të 24-të të thirrur nga Prokuroria, filloi të martën paradite dhe vazhdoi të mërkurën. Dëshmitari është shqiptar nga Kosova, që ishte anëtar i LDK-së, si edhe anëtar i UÇK-së në vitet 1998-1999. Të mërkurën, me përfundimin e dëshmisë së tij, dëshmitari i 23-të i thirrur nga Prokuroria vazhdoi dhënien e dëshmisë që kishte filluar të hënën, përmes videokonferencës.

Pas kësaj, të mërkurën pasdite, Daglas Jang, ish-epor i ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar, që shërbeu në misionet të ndryshme ndërkombëtare në Kosovë, filloi dhënien e dëshmisë së tij pa masa mbrojtëse. Z. Jang është dëshmitari i 25-të i thirrur nga ZPS-ja deri tani.

Dëshmitarët që dhanë dëshmi këtë javë u morën në pyetje nga Prokuroria dhe nga ekipet e Mbrojtjes. Krahas tyre, edhe gjykatësit e Trupit Gjykues u parashtruan pyetje dëshmitarëve.

Të premtën e kaluar, u lëshua versioni i redaktuar publik i një vendimi të mëparshëm të Trupit Gjykues, i qershorit të këtij viti. Në vendim, Trupi Gjykues miratoi pjesërisht, me disa kushte, kërkesën e Prokurorisë





për pranim në prova të deklaratave dhe dokumentacionit të një numri dëshmitarësh. Vendimi gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Seanca e radhës në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* është planifikuar për të hënë, 25 shtator, në orën 9:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, seancat e planifikuara për datat 18 dhe 19 shtator janë anuluar. Seanca e radhës do të mbahet më 20 shtator, gjatë së cilës është planifikuar që Mbrojtja të fillojë me paraqitjen e provave të saj.

### **Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

